



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**“HASAN PRISHTINA”**  
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 · E-mail: rektorati@uni-pr.edu · eëë.uni-pr.edu

---

**Fakulteti:** Bujqësisë dhe veterinarisë

**Departamenti:** Pemëtari - Vreshtari

**Programi:** Pemëtari Vreshtari

**NJOFTIM**

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se :

Ekzemplari (drafti ) i temës së masterit i punuar nga kandidati/ja Blendi Ademaj, me titull:  
**“Hulumtimi i mbirjes së kokrrave të polenit te kultivari i dardhës Santa Maria”**

ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data 04 deri me datë 11.02.2025.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. dr. Bedri Dragusha kryetar
2. Prof. asoc. Vahid Avdiu mentor - anëtar,
3. Prof. ass. Gëzim Hodolli, anëtar

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonte te udhëheqësi shkencor i temës Prof. asoc. Vahid Avdiu, përmes e-mail adresës vahid.avdiu@uni-pr.edu.

Për të pasur një informacion paraprak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji është i mirëseardhur dhe mund të jetë një pasurim i punës tonë !

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**

**FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË**

**DEPARTAMENTI PEMËTARI -VRESHTARI**

**PROGRAMI PEMËTARI DHE VRESHTARI**



**PUNIM I DIPLOMËS MASTER**

**HULUMTIMI I MBIRJES SË KOKRRAVE TË POLENIT TE**

**KULTIVARI I DARDHËS SANTA MARIA**

**Mentor:**

**Prof. asoc. Dr. Vahid Avdiu**

**Kandidati:**

**Bsc. Blendi Ademaj**

**Prishtinë, 2025**

## ABSTRAKTI

Në vitin 2024, ka filluar studimi mbi hulumtimin e mbirjes së kokrrave të polenit tek kultivari i dardhës Santa Maria. Hulumtimi është kryer në fermën private në fshatin Lubovë, Komuna Istog. Njëkohësisht në këtë hulumtim është përfshirë edhe formimi dhe zhvillimi i frutave në bimët ku janë marrë lulet për hulumtim. Pjalmimi dhe pllenimi janë bazat kryesore mbi të cilat zhvillohet frutdhënia e suksesshme e dardhës. Duke pasur parasysh që mbirja e kokrrave të polenit është një proces shumë i ndërlikuar duke u ndikuar nga shumë faktorë, si faktorët e jashtëm dhe ata të brendshëm, ky studim është bërë me qëllim për identifikimin e mbirjes së kokrrave të polenit tek kultivari i dardhës Santa Maria. Gjatë këtij studimi është përdorur metoda e ‘pikës së varur’ përkatësisht përdorimi i tretësirës së Saharozës (sheqer i zakonshëm) si teren ushqyes për mbirjen e kokrrave të polenit. Zhvillimi e këtij hulumtimi ka qenë i ndërlidhur me procesin e lulëzimit. Fillimisht është bërë grumbullimi i luleve sipas fenofazave të lulëzimit: fillimi i lulëzimit, lulëzimi i plotë dhe mbarimi i lulëzimit. Janë zgjedhur lulet e hapura dhe të zhvilluara mirë, këputja është bërë me dorë dhe janë vendosur në epruveta plastike të pastra duke i ruajtur me kujdes deri në laboratorin e Pemëtarisë në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinares në Prishtinë. Kokrrat e polenit në përqendrime të ndryshme të saharozës 10%, 15%, 20%, janë vëzhguar përmes mikroskop elektronik me kamerë për 120 minuta, në intervale kohore (10’, 20’, 30’, 40’, 50’, 60’, 120’). Mikroskopi elektronik ka qenë i lidhur drejtpërdrejtë me PC dhe dinamika e mbirjes së polenit është regjistruar përmes fotografive të realizuara nga kamera e mikroskopit. Gjatë hulumtimit në intervalet përkatëse kohore dhe përqendrime perkatëse të saharozës, është vërejtur se një pjesë e kokrrave të polenit nuk arrijnë të mbijnë, një pjesë e kokrrave fillojnë të mbijnë por gypi gjerminativ nuk zgjatet, një pjesë e kokrrave para se të mbijnë ose kur të fillojnë të mbijë gypi gjerminativ shpërthen (aborton) dhe një pjesë arrin të zhvilloj normalisht gypin gjerminativ. Në përgjithësi aktivizimi i kokrrave të polenit ka qenë më i ulët në fazën e lulëzimit të plotë dhe më i lartë në përfundim të lulëzimit. Aktiviteti më i lartë i kokrrave të polenit në të gjitha fenofazat e lulëzimit, është treguar në përqëndrimin 20 % saharozë. Gjatë intervalit të mbikëqyrjes prej 120 minutave incimit të mbirjes së kokrrave të polenit kryesisht ka ndodhë në intervalet (10 – 20; 30 – 50 dhe 60 - 120 minuta). Abortimi (shpërthimi) i kokrrave të polenit ka ndodhë më së tepërmi në intervalet kohore (30 – 50 dhe 60 – 120 minuta). Mbirja e plotë e kokrrave të polenit më së shumti ka ndodhë në mes 60 – 120 minutave.

Fjalët kyçe: Dardha, Santa Maria, lulëzimi, poleni, mbirja, saharoza,.